



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA
BASKETBALL FEDERATION OF KOSOVO

Nr. 526 Dt. 15.08.2023
PRISHTINË • PRIŠTINA • PRISTINA

Federata e Basketbollit
të Kosovës
+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr. 83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

Në bazë të Rregullores Disiplinore të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), Komisioni Disiplinor i FBK-së, me datë 15.08.2023 merr këtë:

VENDIM

- I. Shpallet e PRANUESHME kërkesa e Trajnerit të Përfaqësueses U18 të Kosovës e datës 03.08.2023.
- II. SHQIPTOHET ndalesë kohore për lojë në të gjitha aktivitetet e organizuara nga FBK në kohëzgjatje prej dy (2) muajsh për lojtarin e Përfaqësueses U18, Jon Ukaj.

ARSYETIM

Me datë 11.08.2023, Komisioni Disiplinor (KD), përmes postës elektronike nga Sekretarja e Përgjithshme e FBK-së, ka pranuar kërkesën për inicim të procedurës disiplinore ndaj lojtarit Jon Ukaj, në lidhje me sjelljen e tij përgjatë FIBA Kampionatit Evropian U18, Divizioni B, që u mbajt në Matosinhos të Portugalisë.

Në këtë kuadër, KD ka mbajtur takim më 15.08.2023. Në takim kanë qenë prezent anëtarët e KD: Omer Daku (Kryetar), Armend Hamiti (Anëtar), Blerim Vuniqi (Anëtar), si dhe në përputhshmëri me nenin 37 të Rregullores Disiplinore, Sekretarja e Përgjithshme e FBK-së.

Sipas kuptimit të Komisionit Disiplinor, Trajneri i Përfaqësueses U18 të Kosovës, me inicimin e procedurës disiplinore të datës 03.08.2023, sugjeron shqiptimin e masave adekuate disiplinore ndaj lojtarit Jon Ukaj sa i përket sjelljes së tij gjatë FIBA Kampionatit Evropian U18, Divizioni B, me theks të veçantë sjelljes në ndeshjen mes Holandës dhe Kosovës së datës 22.07.2023.

Gjatë trajtimit të rastit u shqyrtuan provat dhe dokumentet në dispozicion, gjegjësisht: kërkesa për inicimin e procedurës disiplinore (ku përfshihet edhe deklarata e Trajnerit të Përfaqësueses U18 rreth sjelljes së lojtarit), deklaratat nga lojtari Jon Ukaj si dhe nga prindërit e lojtarit, dhe incizimi nga ndeshja mes Holandës dhe Kosovës, dhe u konstatua si në dispozitiv, për arsytet në vijim.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës
+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjja "Arbëria"
Blloku C3, Nr. 83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

1. Kompetenca e KD për të shqyrtuar rastin

Duke u thirrë në nenin 4 dhe 33 të Rregullores Disiplinore, Komisioni Disiplinor ka kompetencë të shqyrtojë kërkesën nga Trajneri i Përfaqësueses U18 të Kosovës për shqiptimin e masave disiplinore ndaj lojtarit në fjalë.

2. Meritat e Vendimit

Pas shqyrtimit të provave dhe dokumenteve në dispozicion, Komisioni Disiplinor ka vlerësuar sipas bindjes së lirë.

Në kërkesën për inicim të procedurës disiplinore të datës 03.08.2023, Trajneri i Përfaqësueses Kosova U18 ka shpjeguar se gjatë kampionatit në fjalë kanë hasur vazhdimisht në 'probleme me sjelljen dhe gjuhën e trupit të lojtarit gjatë seancave stërvitore si dhe gjatë ndeshjeve të kampionatit'. Kjo sjellje ka kulmuar në çerekun e 4-të të ndeshjes mes Holandës dhe Kosovës, ku gjatë një time out-i lojtari shihet duke e hedhur fanellën e Kosovës në tokë (e cila konfirmohet edhe nga video incizimi i ndeshjes), dhe pas afrimit të njërit prej trajnerëve tek lojtari për ti sugjeruar që ta veshë fanellën, ai është shprehur në mënyrë jo-sportive. Sipas Trajnerit, 'gjatë gjithë ndeshjes lojtari ka treguar një arrogancë ndaj bashkë-lojtarëve si dhe trajnerëve duke mos pranuar këshillat për lojë si dhe sjellje'.

Në bazë të nenit 80 të Rregullores Disiplinore të FBK-së, 'lojtari ... i cili merr pjesë në reprezentacion ose në ndeshje ndërkombëtare, me veprimet e veta dëmton autoritetin e sportit të basketbollit: dënohet me ndalesë kohore për lojë'. Bazuar në deklaratën e Trajnerit dhe incizimin e ndeshjes Holanda-Kosova, lojtari shihet duke hedhur fanellën e Kosovës në tokë në mënyrë jo-sportive dhe rrjedhimisht duke vepruar kundër nenit të lartpërmendur. Për më shumë, deklaratat e dorëzuara nga lojtari dhe prindërit e tij shprehin keqardhje, duke pranuar gabimin dhe duke kërkuar falje sa i përket ndodhjeve. Kjo e fundit, sipas Nenit 25 të Rregullores Disiplinore, do konsiderohet si rrethanë lehtësuese.

Në përputhje me nenet paraprake, Komisioni Disiplinor shqipton dënim me ndalesë për lojë ndaj lojtarit Jon Ukaj për periudhë kohore prej dy (2) muajsh.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:





FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës
+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr. 83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

Ky vendim hyn në fuqi më 15.08.2023 dhe mbetet në fuqi deri më 14.10.2023.

Armend Hamiti
Anëtar

KOMISIONI DISIPLINOR :

Omer Daku
Kryetar

Blerim Vuniqi
Anëtar

Vendimi i dërgohet:

- Lojtarit Jon Ukaj (dhe prindërve të tij);
- Anëtarëve të Komisionit Disiplinor të FBK-së;
- Komisionit të Garave;
- KB Vëllaznimi;
- Iniciuesit të procedurës disiplinore (Trajneri i Përfaqësueses U18);
- Menaxherit të Përfaqësueseve në FBK;
- Arkivit të FBK-së.



KËSHILLË JURIDIKE: Konform Nenit 43 të Rregullores Disiplinore, kundër vendimit të Komisionit Disiplinor të shkallës së parë mund të parashtrahet ankesë në afat prej 3 ditësh, duke llogaritur nga dita e përcjelljes së vendimit, kurse i paraqitet Komisionit Arbitrar. Me rastin e paraqitjes së ankesës, paraqitësi duhet të paguaj në llogari të FBK taksën në shumën prej 300 €, mjete të cilat i kthehen paraqitësit nëse i miratohet ankesa.

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball supporters:

